




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **-IX-**, të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **29.12.2020, (e Marte)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Vitisë në Shtëpinë e Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Kuvendi Komunal të Vitisë
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimi e propozim vendimit për miratimin e listës së veçant të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjate vitit 2021
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim plotësimit të Propozim rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Nr. 02-110/05-1270 e datës 04.12.2020.
5. Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën janar- dhjetor 2020

Me respekt!
Viti, më 23.12.2020


Kryesuesi i Kuvendit
Naim Pira



KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
Pranuar - Prilajeno Mirëdora			
Nr. i organit	Kontri/Euroj	Shtetëse	Vlera
Org.broj		Prilicj	Vrednost
02-036/02-1341			

Republika e Kosovës/ Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë/ Opština Vitina/ Municipality of Viti



Në bazë të nenit 12, nenit 17 shkronja (b), neni 40 shkronja (1) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28 qershor 2008), nenit 5. nën paragrafi 1.2., nen-nen paragrafi 1.2.1. dhe nenet 10. Paragrafi 2. Nenparagrafi 2.1., 11., 15. dhe nenit 26 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor 04/L-174, datës 23.08.2013 si dhe UDHËZIMI ADMINISTRATIV MMPH - NR. 11/2015 MBI ELEMENTET DHE KËRKESAT THEMELORE PËR HARTIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL; Neni 11, paragrafi 11.2.2, Neni 50 paragrafi 50.1 pika n të Statutit të Komunës së Vitisë, 01-013/491 datë 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë propozonë këtë:

PROPOZIM - VENDIMI PËR HARTIMIN E

Plani Zhvillimor Komunal

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim fillohet hartimi i Planit Zhvillimor Komunal i Komunës Vitisë.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal në harmoni me ligjin si Plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për periudhën tetë (8) vjeçare.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me Planin Zhvillimor Komunal nga neni 1. i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor të Komunës së Vitisë, plotëson kërkesat ligjore për të përgatitur Planin strategjik multi-sektorial, i cili përfshin planifikimin dhe zhvillimin e zonës urbane dhe rurale.

Neni 4

Kufiri i territorit

Zonat Kadastrale në territorin e Komunës së Vitisë të përfshira janë :

Nr,	Zona Kadastrale	Shifra	ha	a	m ²
1	Ballancë	70101001	755	15	72
2	Beguncë	70101002	480	53	3
3	Binçë	70101003	1236	22	31
4	Budrikë e Epërme	70101012	449	5	39
5	Buzovik	70101004	570	95	70
6	Debëlldeh	70101017	945	35	61
7	Devajë	70101018	364	84	57
8	Gërmovë	70101014	626	35	60
10	Gjylekarë	70101022	1084	40	50
11	Gushicë	70101016	1155	91	55
12	Kabash	70101025	725	91	2
13	Letnicë	70101027	443	12	8
14	Lubishtë	70101028	1084	81	63
15	Mjak	70101029	604	62	13
17	Novosellë	70101031	472	80	1
18	Podgorc	70101032	323	75	75
19	Pozheran	70101033	1120	30	31
20	Radivojc	70101035	365	87	31
21	Ramjan	70101020	675	65	13
22	Ramnishtë	70101034	94	76	12
23	Remnik	70101036	1068	21	48
24	Sadovinë e Jerlive	70101024	285	54	84
25	Sadovinë e Çerkezëve	70101040	840	75	80
26	Shasharje	70101042	1050	97	67
27	Sllatinë	70101037	1145	59	94
28	Smirë	70101038	1723	61	66
29	Stubëll e Epërme	70101013	652	77	77
30	Tërpezë	70101005	1331	87	4
31	Tërstenik	70101039	376	46	66
32	Vërban	70101008	803	86	81
33	Vërnakollë	70101010	556	74	35
34	Vërnez	70101011	842	48	3
35	Viti	70101007	1078	50	96
36	Zhiti	70101023	875	24	5
37	Drobesh	70101021	291	1	16
38	Stubëll e Poshtme	70101019	163	74	21
39	Goden i Madh	70101006	191	32	94
40	Qifllak	70101041	134	32	64

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal caktohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit koordinon procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës.

Neni 7

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1. të këtij vendimi është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor të hartojë në afat deri 18 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8

Konsultime Publike

Projekti i Planit Zhvillimor Komunal para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Planit Zhvillimor Komunal në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Afati i Vlefshmërisë

Dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal hartohet për periudhën kohore 8 (tetë) vjeçare.

Neni 10

Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jete në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11

Programi

Pjese e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë me nenin 11. pika 1.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinorë Nr. 04/L-174

Neni 12

Programi

Me miratimin e këtijë Vendimi nga Kuvendi i Komunës së Vitisë, shfuqizohet Vendimi Për hartimin e Planit Zhvillimor komunal me nr. protokoli 01-110/05-245 i datës 30.03.2018.

Neni 13

Hyrja ne fuqi

Me miratimin nga Kuvendi i Komunës së Vitisë, ky Vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03-L- 040 dhe publikimi në ëeb-faqen Zyrtare të Komunës.



Kryetari i Komunës

/z. Sokol Haliti/

Viti, 16.12.2020



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA



Pranuar - Prilajeno Më Dhomë 21.12.2020
Org.broj 02-035/2020
Kumari/Pro 13/28
Prilog
Vednost

Në bazë të nenit 11, 14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008 dhe neni 13 dhe 8 paragrafi 3, të Ligjit me nr. 06/L-092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja l, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi me datën 18.12.2020, bën këtë :

PROPOZIM VENDIM

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË VEQANT TË PRONAVE TË PALUJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHEN PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM GJATË VITIT 2021

Neni 1

Me këtë propozim – vendim , propozohet të miratohet Lista e veqant e pronave të palujtshme të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2021.

Neni 2.

Lista sipas nenit 1 të këtij propozim-vendimi për secilen pronë arsyetimin e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik të Komunës , të dhënat kadastrale , qellimin e dhënjes në shfrytëzim , destinimi i pronës parashikimi.

Neni 3

Pjesë përberse e këtij propozim vendimi është Lista e veqant e pronave të të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2021 përfshirë kartifikaten e pronës dhe kopjen e planit.

Neni 4

Për zbatimin e këtij propozim – vendimi dhe procedurat tjera të parapara ,me të Ligjit me nr. 06/L-092 , Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës Obligohet Drejtoria e Kadastrit, Pronës dhe Gjeodezisë ne bashkpunim dhe kordinim me Drejtorit tjera të Komunës varsisht fushveprimtarisë përkatëse . Zyra e Kryetarit të Komunës , Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Financave të komunës së Vitisë.

Neni 5.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGJENCIA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101012-00641-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 3355/2020
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 21.12.2020 - 08:54
Komuna / Opština / Municipality: Viti / Vitina / Viti
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: BUDRIKË E EPËRME / GORNJA BUDRIKA / BUDRIKË E EPËRME
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Viti / Vitina / Viti

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70101012-00641-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	155000	ne baze te kërkeses dalje ne teren nr:07.952-10/36 dt.18.05.2009 ne baze te vendimit te K.K. Viti nr:463/9 dt.10.05.1968 Në bazë të kërkesës për ndarje fizike nr: 83/2016, dt. 07.06.2016, Vendimi i Kuvendit Komunal nr. 01-013/1640, dt.10.12.2015	08.06.2016	08.06.2016

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
BATENICA/BATENICA/BATENICA		BATENICA	08.06.2016	08.06.2016

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 3/Njiva 3 Klase/3rd Class Arable Land	155000

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Druzavina / single possessor	P.SH. K.K. VITI	KCID0115241	VITI / VITINA / VITI /			I/I	ne baze te kerkeses dalje ne teren nr.07.952-10/36 dt.18.05.2009 ne baze te vendimit te K.K.Viti nr.463/9 dt.10.05.1968	08.06.2016



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA



LISTA E VEQANT E PRONAVE TË PALUJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHET PËR
DHËNJEN NË SHFRYTËZIM GJAT VITIT 2021.

Nr.	Të dhënat kadastrale të pronës	Arsyetimi i interes publik dhe zhvillimi ekonomik	Destinimi	Periudha kohore për dhënjën në shfrytëzim të pronës së palujtshme
1.	Palujtshmeria e evidentuar në Cartifikatne e pronës nr.3355/2020 e datës 21.12.2020, numri i njësisë kadastrale P-70101040-01785-0 në sipërfaqe prej 3968 m ² , Kullosë në vendin e quajtur "Zhar zhar" në zonën kadastrale në Sadovinë e Çerkezëve.	Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë.	Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për shfrytëzimin bujqësor	Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter.
2.	Palujtshmeria e evidentuar në Cartifikatne e pronës nr.3355/2020 e datës 21.12.2020, numri i njësisë kadastrale P-70101040-01784-1 në sipërfaqe prej 37151 m ² , Toka pyjore në vendin e quajtur "Zhar zhar" në zonën kadastrale në Sadovinë e Çerkezëve.	Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë.	Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për shfrytëzimin bujqësor	Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter.
3.	Palujtshmeria e evidentuar në Cartifikatne e pronës nr.3355/2020 e datës 21.12.2020, numri i njësisë kadastrale P-70101012-00641-1 në sipërfaqe prej 155000 m ² , Bujqësore, në vendin e quajtur "Batonica" në zonën kadastrale në Budrikë e Epërme.	Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë.	Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për Zonë industriale – ekonomike .	Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter.

Me datën 21.12.2020, Viti.

Drejtori:
Majlinda Ostrogllava

Kryetari i Komunës:
Sokot Haliti



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VITI

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Sadovinë e çerkezëve

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70101040-01785-0	Parcelë / Parcela / Parcel	3968
P-70101040-01784-0		



Shkalla/Razmera/Scale: 1:3818

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 22.12.2020

Koha/ Vreme/ Time: 09:19:32

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VITI

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Budrikë e epërme

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70101012-00641-1	Parcelë / Parcela / Parcel	155000



Shkalla/Razmera/Scale: 1:3970

33 55/20

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 22.12.2020

Koha/ Vreme/ Time: 09:22:13

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo
Viti/na

			
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA			
Prindar - Prindësitë Mëdha		21-12-2020 vit/gor.	
Nr. organit Org. brejt	Nr. nr./Drej.	Shkollë Prilog	Vlera Wednost
02-035/02-1345			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of

PROPOZIM RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN-PLOTESIMIN E RREGULLORES
PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA ME NR. 02-110/05-1270, E DT.04.12.2020

VITI, 18.12.2020

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 lidhur me nenin 50 të statutit të Komunës së Vitisë Nr 01-013/491 të datës 21.04.2011 lidhur me nenin 9 dhe 13 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-049 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27/2008, Kryetari I Komunës në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore propozon këtë :

PROPOZIM RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN-PLOTESIMIN E RREGULLORES
PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA ME NR. 02-110/05-1270, E DT.04.12.2020

Neni 1

Kjo rregullore ka për qellim ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale me Nr. 01-110/05-920, të datës 01.10.2020, me kërkesën e MAPL-se Nr.43-734/1 të datës 16.10.2020

Neni 2

Te rregullorja bazë, neni 5.1, Lëshimi i certifikatës së lindjes, ekstrakti të lindjes, martesës duhet të përmissohet të jete **Çertifikata e lindjes, ekstrakti nga Regjistri Qendror i gjendjes civile dhe certifikata e gjendjes martesore,**
Pika 5.2, Lëshimi i certifikates mbi statusin martesor duhet të përmissohet të jete **Çertifikatë e gjendjes martesore.**

Pika 5.7, Lëshimi i certifikatës familjare duhet të përmissohet në Deklaratë për bashkësinë familjare.

Pika 5.13. Vendimi mbi regjistrimi e me vonshëm në LAL, LAM DHE LAV dhe te tjera ku çmimi është 3.00€, të përmissohet në **Regjistrimi i fëmijës me vonesë, pas kalimit të afatit ligjor prej 30 ditësh çmimi është 20.00€.**

Kërkohet të inkorporohet **Regjistrimi i vdekjes me vonesë, pas kalimit të afatit ligjor prej 30 ditësh çmimi 50.00 €.**

Ndërsa pika 5.15 e rregullore baze tërhiqet krejtësisht.

Neni 3

(Tek neni 3 hiqen të gjitha udhëzimet administrative me rekomandim të ministrisë të mos jenë të përfshira fare në Rregulloret e Komunave)

Te rregullorja bazë neni 10, Drejtoria për kadastër prone dhe gjeodezi.

Ngarkesat për shërbimet komunale kadastrale

10.1. Regjistrimi i pronësisë, posedimit dhe të drejtave tjera

Regjistrimi i pronësisë, posedimit sipas transaksioneve do të bëhet sipas vlerave të transaksioneve të kryera për pronën e paluajtshme.

- Për vlerën e transaksionit deri në 10.000€ paguhet taksa prej 20€
- Për vlerën e transaksionit prej 10.000€ e deri në 30.000€ paguhet taksa prej 30€
- Për vlerën e transaksionit prej 30.000€ e deri 50.000€ paguhet taksa prej 35€
- Për vlerën e transaksionit prej 50.000€ e deri 100.000 € paguhet taksa prej 50€
- Mbi vlerën e 100.000€, për çdo 50.000 € tejkalim, paguhet vlera prej 30€, por shuma e taksës së përgjithshme nuk mund ta kalojë vlerën e 300€.
- Po që se vlera e kontratës-transaksionit është e pa vlerësueshme paguhet taksa në vlerë prej.....70 €.

10.2. Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të dokumentit mbi dhuratën

○ Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrës është anëtar i familjes apo pasardhësi i dhuratëdhënësit, është e caktuar vlera e pronës, në këto raste do të paguhet 30% taksa-tarifa për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit, sipas tarifës së përcaktuar me nenin 10.1 të kësaj rregullore.

○ Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrës nuk janë anëtarët e familjes apo pasardhësit e dhuratëmarrësit, është e caktuar vlera e pronës, në këto raste do të paguhet taksa-tarifa për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit, sipas tarifës së përcaktuar me nenin 10.1 të kësaj rregullore.

○ Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrës janë anëtarët e familjes së ngushtë dhuratëmarrësit, ndërsa nuk është e caktuar vlera e pronës në kontratë, në këto raste do të paguhet taksa-tarifa në shumën prej 50€ për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën e mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit.

○ Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrës nuk janë anëtarët e familjes së ngushtë dhuratëmarrësit, ndërsa nuk është e caktuar vlera e pronës në kontratë, në këto raste do të paguhet taksa-tarifa në shumën prej 80€ për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit

10.3. Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të dokumentit të organeve administrative dhe gjyqësore mbi njohjen e të drejtës së pronësisë-posedimit.

• Regjistrimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme e cila fitohet në bazë të Vendimit të organit administrativ apo gjyqësor, bëhet duke paguar taksën-tarifën në shumë prej 50€.

10.4. Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) të pronës bashkëpronësi

• Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bashkëpronësi bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 20€, për një akt juridik me të cilin është vendosur bashkëpronësia.

• Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) fizike të pronës nga bashkëpronësia, pagesa bëhet duke paguar nga 20€ nga secili bashkëpronar që bëhet pronar individual nga pjesëtimi fizik i pronës.

• Për regjistrimin e pronës së përbashkët të bashkëshortëve bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 20€ për një akt juridik me të cilin është vendosur prona e përbashkët.

• Regjistrimi i pronësisë së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 20€.

• Regjistrimi i pronësisë së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi me të gjithë pronarët e pjesëve të veçanta bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 100€.

10.5. Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të Trashëgimisë dhe të shkëputjes së bashkësisë familjare

• Regjistrimi i pronësisë, në bazë të Trashëgimisë bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 10€ për çdo trashëgimtar.

• Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 10€ për çdo anëtar të familjes që bëhet pronar-posedues.

10.6. Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme

• Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme, bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 30€ për secilin pronar-posedues.

10.7. Regjistrimi i hipotekës

Regjistrimi i hipotekave do të bëhet sipas vlerave të kërkesave (kredive) të përcaktuar me dokumentin e hipotekës dhe atë:

• Kërkesa (kredia) në vlerën deri 10.000€, paguhet taksa-tarifa në shumën prej10€

• Kërkesa (kredia) në vlerën prej 10.000€ e deri në 30.000€ paguhet taksa-tarifa në shumën prej20€

- Kërkesa (kredia) në vlerën prej 30.000 € e deri në 50.000 € paguhet taksa-tarifa në shumën prej30 €
- Kërkesa (kredia) në vlerën prej 50.000€ e deri në 100.000€ paguhet taksa –tarifa në shumën prej80 €
- Mbi vlerën e 100.000 €, për çdo 100.000€ tejkalim paguhen edhe nga 30€, por shuma e tarifës-taksës nuk mund ta kalojë vlerën e400€

10.8 Ndryshimi dhe fshirja e hipotekës

- Ndryshimi i hipotekës së regjistruar bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 30€
- Për fshirjen e hipotekës nga Regjistri i të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 10€.

10.9. Regjistrimi i servituteve

- Regjistrimi i të drejtës së servitutit në Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 50€.
- Fshirja e Servitutit nga regjistri bëhet duke paguar tarifën në shumën prej..... 20€.

10.10. Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit-qirambajtja

- E drejta e shfrytëzimit - qirambajtje me kohëzgjatje prej 3 deri në 10 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifën në shumë prej 50 €.
- E drejta e shfrytëzimit - qirambajtja në kohëzgjatje prej 10 deri në 25 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifën në shumën prej 150€.
- E drejta e shfrytëzimit - qirambajtja me kohëzgjatje deri në 99 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifën në shumën prej500 €.
- Për ndryshimin dhe fshirjen e të drejtës së shfrytëzimit - qirambajtja bëhet duke paguar 20% e shumës që është paguar për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit.
- Me rastin e bartjes së të drejtës së shfrytëzimit - qirambajtjes ose nënqiranë tek personat e tretë paguhet tarifa e cila është e përcaktuar me nenin 10.1 dhe 10.2 të kësaj rregullore.

10.11. Regjistri i barrëve dhe ngarkesave të ndryshme

- Për regjistrimin e barrës në tatimin në pronën e paluajtshme bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 20€.
- Për regjistrimin e barrës tatimore bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 30€.
- Për regjistrimin e masës së sigurisë (masa e përkohshme), që procedua gjyqësore ose një procedurë tjetër është udhëhequr me kërkesë private të palës, duhet të paguhet tarifa prej 50€.
- Për regjistrimin e masës së sigurisë (masa e përkohshme), që procedua gjyqësore ose një procedurë tjetër është udhëhequr sipas detyrës zyrtare nga një organ kompetent për zbatimin e ligjit (Prokuroria, policia etj) nuk do të paguhet asnjë tarifë.

10.12 Korrektimi i të dhënave në regjistër

- Nëse të dhënat që duhet të korrigjohen janë futur në regjistër sipas dokumentacionit të dorëzuar nga palët, korrektimi i tyre bëhet duke paguar nga pala 20€.
- Nëse të dhënat që duhet të korrigjohen janë futur në regjistër me variorimin e Zyrës kadastrale Komunale ose nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, atëherë korrektimi bëhet pa pagesë.

10.13. Regjistrimi i të drejtave tjera

- Regjistrimi i të drejtave, ngarkesave, barrës pronësore të tjera mbi pronën e paluajtshme e të cilat nuk janë përfshirë në dispozitat e kësaj rregullore do të regjistrohen duke paguar tarifën në shumën prej 40€.

10.14. Ndërrimi i kulturave të parcelave:

- Ndërrimi i kulturës të një parcele pa matje gjeodezike.....10 €
- Ndërrimi i kulturës të një parcele me matje bëhet sipas tarifave të përcaktuara me nenin 10.15 të kësaj rregullore.

10.15. Ndarja e parcelave

- Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike në teren deri në 0.50ha.....75€
- Për çdo ndarje në pjesë tjetër25 €
- Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike në terren në sipërfaqe 0.50ha
100€
- Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike në terren në sipërfaqe 1ha –
5.0ha.....150€
- Ndarja e një parcele në pjesë të përcaktuara më parë80€
- Ndarja në më tepër se dy pjesë të përcaktuara më parë për çdo pjesë40€
- Ndarje e komplekseve me sipërfaqe prej 5-10ha në dy pjesë200€
- Për çdo ndarje në pjesë tjetër100€
- Ndarja e komplekseve me sipërfaqe mbi 10ha500€
- Për çdo ndarje në pjesë tjetër200€

10.16. Bashkimi i parcelave

- Bashkimi i parcelave pa matje20€
- Për çdo parcelë tjetër në kufi10€

10.17. Matja e ndërtesave:

- Matja për një ndërtesë individuale për një m² të bazës gjeodezike.....0,50€
- Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë.....0,25€
- Ndërtesa banimi kolektiv për 1m².....0,50€
- Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1m².....0,50€
- Ndërtesa afariste për 1 m².....0,70€
- Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë, për 1m².....0,70€
- Ndërtesë banesore-afariste, për 1m².....0,70€
- Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë, për 1m².....0,50€
- Ndërtesë e administratës qeveritare dhe publike për 1m².....0,50€
- Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1m².....0,50€
- Objekte për sport dhe rekreacione (stadione, halla sportive etj) për 1m².....0,50€
- Objekte kulturore dhe fetare, për 1m².....0,30€
- Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë, për 1m².....0,50€

10.18. Matja e pjesëve të ndërtesave:

- Hapësirat banesore dhe përpilimi i skicës, për 1m².....0,80€
- Kati me skicat e njësive të veçanta për 1m².....0,70€
- Ndarja e hapësirave banesore dhe përpilimi i skicës, për 1m².....1,00€
- Ndarja e hapësirës afariste dhe përpilimi i skicës për çdo pjesë, për 1m².....0,75€

10.19. Matja e përçojave

- Përçoja nëntokësore, për metër gjatësi0,50€
- Përçoja mbitokësore, për metër gjatësi0,25€
- Objekte nëntokësore100.00€
- Për çdo objekt tjetër.....50.00€
- Tunelet për metër gjatësi.....5.00€

10.20. Përcaktimi i kufijve të parcelave

- Për një parcele me sipërfaqe gjerë 0.50ha80,00€
- Për një parcelë me sipërfaqe prej 0.50ha – 1.00ha100.00€
- Për çdo parcelë tjetër mbi 1ha60.00€
- Për parcelat urbane sipas Planit Urbanistik (pas marrjes së pëlqimit nga Drejtoria
e
Urbanizmit120.00€

10.21. Rirregullimi i kufijve të parcelave

- Për një parcelë me sipërfaqe prej gjer 0.50ha.....40.00€
- Për parcelë me sipërfaqe prej 0.50ha-1.00ha50.00€
- Për çdo parcelë tjetër me sipërfaqe mbi 1.00ha30.00€

10.22. Dhënia e dëshmive në bazë të dhënave kadastrave tekstuale apo grafike sipas kërkesave të palëve nga ZKK

- Dhënia e vërtetimeve të ndryshme3,00€
- Çertifikata mbi pronën 4,00€
- Kopja e planit për një parcelë 5,00€
- Për çdo parcelë tjetër.....2,00€
- Historiati për një parcelë.....30,00€

10.23. Punët e zyrës sipas kërkesave të palëve

- Identifikimi i njësive kadastrave në teren për njësi të kadastrave 20,00€
- Për çdo njësi tjetër në kufi..... 5,00€
- Kontrollimi dhe regjistrimi në regjister i të dhënave nga terreni për njësi 20,00€

10.24. Punët e veçanta gjeodezike

- Bartja në teren e të dhënave nga planet urbanistike për objekt individual për m² ... 0.50€
- Bartja në teren e të dhënave nga planet urbanistike për objekt banimi kolektiv apo afarist për m² 0,50€.

10.25. Baza gjeodezike

Pikat trigonometrike:

Koordinatat Y-X..... 5,00€

Pikat Poligonale:

Koordinatat Y-X-Z 3.00€

Pikat e detajit:

Koordinatat Y - X.....1.00€

Pikat lidhëse:

Koordinatat Y-X3.00€

Koordinatat Y-X-Z.....5.00€

Pikat Linjë

Koordinatat Y-X-Z.....2.00€

Vendosja e pikave trigonometrike50.00€

Neni 10 i rregullores baze duhet të permisohen të jenë:

DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI

Ngarkesat për shërbimet komunale kadastrale

10.1. Regjistrimi i pronësisë, posedimit dhe të drejtave tjera

Regjistrimi i pronësisë, posedimit sipas transaksioneve do të bëhet sipas vlerave të transaksioneve të kryera për pronën e paluajtshme.

- Për vlerën e transaksionit deri në 10.000€ paguhet taksa prej 30€
- Për vlerën e transaksionit prej 10.001€ e deri në 50.000€ paguhet taksa prej 50€
- Për vlerën e transaksionit prej 50.001€ e deri 100.000€ paguhet taksa prej 70€
- Për vlerën e transaksionit prej 100.001€ e deri 200.000 € paguhet taksa prej90€
- Për vlerën e 200.001€ deri në 500.000 € duhet të paguhet vlera prej120€,

- Për vlerën e transaksionit prej 500.001€ deri në 1.000.000 € paguhet taksa prej 240 €
- Po që se vlera e kontratës-transaksionit mbi 1.000.000 € paguhet taksa në vlerë prej.....500 €.
- Për vlerën e kontratës-transaksionit që është vertetuar para vitit 1999, tarifa është 50 €.

Tarifat e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, zbatohen në të gjitha rastet kur nuk është e përcaktuar me dispozita të veqanta tarifat për rexhistrimin.

10.2. Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të dokumentit mbi dhuratën

- Tarifat për rexhistrimin e pronësis sipas dokumentin (kontratën) mbi dhurimit për anëtarin e familjes është 30 €.
- Tarifat për rexhistrimin e pronësis sipas dokumentin (kontratën) mbi dhurimit për personin që nuk është anëtarin i familjes dhe nuk është caktuar vlera tarifës është 80 €.
- Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrës nuk janë anëtarët e familjes apo pasardhësit e dhuratëmarrësit, është e caktuar vlera e pronës, në këto raste do të paguhet taksa-tarifa sipas nenin 10.1 të kësaj rregullore.

10.3. Tarifa e regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të dokumentit të organeve administrative dhe gjyqësore mbi njohjen e të drejtës së pronësisë-posedimit.

- Regjistrimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme e cila fitohet në bazë të Vendimit të organit administrativ apo gjyqësor, bëhet duke paguar taksën-tarifën në shumë prej 30€, për çdo pronar.

10.4. Tarifa e regjistrimi i bashkpronësisë apo pronës së përbashkët

- Regjistrimi i pronësisë i të drejtës së bashkëpronësi apo pronësi së përbashkët bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 30€.
- Për regjistrimin e pronës së përbashkët të bashkëshortëve bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 30€.
- Regjistrimi i pronësisë së njërive kadastrale si pjesë e ndërtesës paguar tarifën në shumën prej 25€.
- Lirohet nga tarifa për regjistrimi e pronësisë së përbashkët të ndërtesave kolektive në bashkëpronësi.
- Lirohet nga tarifa për regjistrimi e hapsirave të përbashkët si njësi të veqanta.

10.5. Tarifa e regjistrimi i bashkpronësisë apo pronës së përbashkët

- Tarifa për rexhistrimin e pronësis në bazë të ndarjes nga bashkpronësia apo pronësia e përbashkët për secilin bashkpronarë që behet pronar individual paguhet 30 €.
- Lirohet nga tarifa për rexhistrimin e ndarjes nga bashkpronësia sipas nenit 6 paragrafi dhe 4 i udhëzimit për ndarjen dhe rexhistrimin e parcelave.

10.6. Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të Trashëgimisë dhe të shkëputjes së bashkësisë familjare

- Regjistrimi i pronësisë, në bazë të Trashëgimisë bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 10€ për çdo trashëgimtar.
- Regjistrimi i pronësisë, në bazë të Trashëgimisë e cila rrjedh nga testamenti bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 20€.

- Tarifa e regjistrimi të pronësisë, posedimit në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 20€ për çdo anëtarë të familjes që bëhet pronar-posedues.

10.7. Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme

- Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme, bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 40€ për secilin pronar-posedues

10.8. Regjistrimi i hipotekës

- Kërkesa (kredia) në vlerën deri 30.000€, paguhet taksa-tarifa në shumën prej20€
- Kërkesa (kredia) në vlerën prej 30.001€ e deri në 50.000€ paguhet taksa-tarifa në shumën30€
- Kërkesa (kredia) në vlerën prej 50.001 € e deri në 100.000 € paguhet taksa-tarifa në shumën60 €
- Kërkesa (kredia) në vlerën prej 100.001€ e deri në 200.000€ paguhet taksa –tarifa në shumën90 €
- Kërkesa (kredia) në vlerën prej 200.001€ e deri në 500.000€ paguhet taksa –tarifa në shumën120 €
- Kërkesa (kredia) në vlerën prej 500.001€ e deri në 1.000.000€ paguhet taksa –tarifa në shumën240 €
- Mbi vlerën e 1.000.000 €, tarifa është400€.
- Hipoteka e cila rexhistrohet në dy apo më shumë ZKK, tarifa pjestohet në menyre të barabart.

10.9 Ndryshimi dhe fshirja e hipotekës

- Ndryshimi i hipotekës së regjistruar bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 10€
- Lirohet nga tarifa fshirjen e hipotekës nga Regjistri i të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme.

10.10. Regjistrimi i servituteve

- Regjistrimi i të drejtës së servitutit për secilen parcel dominante apo person behet duke paguar tarifën në shumë prej 30€.
- Tarifa e për modifikimin e servitutit është10€
- Fshirja e Servitutit nga regjistri bëhet duke paguar tarifën në shumën prej..... 20€.

10.11. Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit-qirambajtja

- E drejta e shfrytëzimit - qirambajtje për çdo njësi kadastrale , kur pronarë është Qeveria apo Komuna , me kohëzgjatje deri 10 vite është10€.
- E drejta e shfrytëzimit - qirambajtje për çdo njësi kadastrale , kur pronarë është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje prej 10 deri 40 vite është.....30€.
- E drejta e shfrytëzimit - qirambajtje për çdo njësi kadastrale , kur pronarë është Qeveria apo Komuna , me kohëzgjatje prej 40 deri 99 vite është50 €.
- E drejta e rexhistrimit e qiras nga përsoneat fizik apo juridik në kohëzgjatje prej 10 viteve, për çdo njësi kadastrale është..... 10€.
- E drejta e rexhistrimit e qiras nga përsoneat fizik apo juridik në kohëzgjatje mbi 10 viteve, për çdo njësi kadastrale është..... 20€.
- Rexhistrimi i të drejtës së shfrytëzimit - qirambajtja për pronat e privatizuar nga nga ish Ndermarrjet Shoqerore me kohëzgjatje prej 99, behet duke zbatuar tarifen e përcaktuar sipas nenit 10.1 të kësaj Rregullore.

10.12. Regjistri i barrëve dhe ngarkesave të ndryshme

- Për regjistrimin e barrës tatimore bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 20€.
- Lirohet nga tarifa regjistrimi i masës së sigurisë (masa e përkohshme) apo modifikimin e saj.
- Tarifa për rexhistrimin e vrejtesë sipas Ligjit për Regjistrin e e të Drejtave të Pronës Palujtshme është 40€.
- Tarifa për rexhistrimin e ndalesës nga Përmbarusi Privat apo Gjykata në procedurë përmbarimore për secilen njësi kadastrale është 30€.
- Tarifa për rexhistrimin e vrejtes të mbajtsit në pronën e palujtshme të të mbajturit në momentin e lidhjesë së Kontratës mbi mbajtjen e përjetshme është..... 20 €.
- Tarifa për modifikimin e barrës apo ngarkesës tjetër është10 €
- Lirohet nga tarifa fshirja e barrës apo ngarkesës tjetër.

10.13. Tarifa për korigjimin e të dhënave kadastrale

- Tarifa për korigjimin e të dhënave kadastrale që konstatohet se janë rexhistruar gabim si pasoj e dokumentacionit të dorzuar nga pala është30€
- Lirohet nga tarifa për korigjimin e të dhënave kadastrale që konstatohet se janë rexhistruar si pasoj e gabimit të ZKK apo AKK, si dhe gabime e konstatuar nga sistemi i mëparshem.
- Lirohet nga tarifa për korigjimin e numrit identifikus ‘KCID’ në numër personal të pronarëve. ZKK është e obliguar që të bejë korigjimin e numrit identifikus “ KCID” sipas detyrës zyrtare.

14. Tarifa për sherbime online

- Tarifa për krijimin e qasjes për shërbime online është :
 - 20 € për një përdorues GUI për person.
 - 100€ për një përdorues UCWSS si institucion.
- Mirmbajtja vjetore për shërbimet e ofruar online është 200 € për secilin institucion;
 - Përjashtimi nga paragrafi 2 i këtij neni behet për personat fizik dhe juridik të cilet rexhistrojnë të drejtën e hipotekës.
 - Bazuar në paragrafin 2.1. të këtij neni rexhistrimi i hipotekës është 5€, ndërsa modifikimi dhe fshirja e saj është pa pagesë.
- Tarifa për verifikimin e informatave për njësi kadastrale për njësi kadastrale.....2€.
- Tarifa për verifikimin e informatave për person..... 6€.
- Tarifa e përcaktuara në paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni , vlejn për të gjitha institucionet publike dhe ato private që me ligj kanë autorizime publike.
- Tarifa për nxjerrjen e certifikatave online është3€.
- Lirohet nga tarifa për rexhistrimin e shënimeve nga përdoruesi sipas paragrafit 1 të këtij neni.Përdoruesitnga paragrafi 1 i këtij neni janë të obliguar që të bëjnë rexhistrimin e shënimeve.

10.15. Tarifa për regjistrimi i të drejtave tjera

- Tarifa për rexhistrimin e të drejtave nuk janë përfshir me dispozitatë kësaj Rregullore është.....50 €.

10.16. Tarifat për dhënien e informatave nga Sistemi i Informacioneve Kadastrale të Tokave të Kosovës nga ZKK-ja

- Vërtetim që personi fizik ose juridik nuk posedon prona - tri Euro (3€).
- Dhënia e vërtetimeve të ndryshme - tri Euro (3€).
- Certifikata e pronësisë (deri në dhjetë faqe shënime të shtypura) - katër Euro (4€).
- Certifikata e pronësisë (mbi dhjetë faqe shënime të shtypura) - njëzet Euro (20€).
- Kopja e planit - katër euro (4€).
- Kopje në formatin A3 me ortofoto (bardhë e zi) – katër euro (4€).
- Kopje në formatin A3 me ortofoto (kolor) – pesë euro (5 €).
- Historiati për një njësi kadastrale – njëzet euro (20 €).
- Kontrollimi dhe regjistrimi në regjistër i të dhënave nga terreni për njësi - njëzet Euro (20€)

10.17. Tarifat për bazën gjeodezike

- Pikat trigonometrike: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim - pesë Euro (5€).
- Pikat lidhëse: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim - katër Euro (4€).
- Pikat poligonale: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim - tri Euro (3€).
- Pikë e nivelimit: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim - pesë Euro (5€).
- Pikat në linjë: Koordinatat Y, X, H - dy Euro (2€).
- Pikat e detajit Y, X, - një Euro (1€).

10.18. Tarifat për të dhënat në formën digjitale

- Parcela në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) deri në 1 ha-sipas kërkesës së pales (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) - dhjetë Euro (10€) për njësi.
- Parcela në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) mbi 1ha deri 2 ha- sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) - njëzet Euro (20€),
- Parcela në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) mbi 2.01ha deri 5 ha- sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) - katërdhjetë Euro (40€),
- Parcela në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) mbi 5 ha- (sipas kërkesës së palës, pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) - gjashtëdhjetëdhjetë Euro (60 €),
- CD—kompakt disku zero euro e pesëdhjetë cent (0.50 €).

10.19. Tarifat e shërbimit për ndërrimin e kulturave të parcelave

- Përgatitja e raportit për ndërrimin e kulturës së një parcele pa matje gjeodezike-dhjetë Euro (10€).

Për zbatimin e nenit 3 të këtij ndryshim plotësim te rregullore do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi.

Neni 4

Te rregullorja bazë, neni 11, duhet të fshihen krejtësisht Vërtetimi për shitjen e prodhimeve bujqësore i cili kushtojnë 10€.

Ndërsa tek ky nene me kërkesën e Ministrisë duhet të shtohen:

Shërbimet profesionale për prerjen të pyjeve private:

- a.) Dru Zjarri mbi 7 m³.....1.50 €
- b.) Dru Zjarri për m³.....2.00 €
- c.) Dru Teknik m³.....2.50 €

Taksa për kullotjen e begëtisë për një (1) vit;

- a.) Gjedhe mbi një vjetcopë.....1.20€
- b.) Viçatcopë 0.80€
- c.) Deletcopë 1.20€
- d.) Qengjatcopë 0.80€
- e.) Kuajt dhe gomarët....copë 1.90€
- f.) Derratcopë 1.60€
- g.) Derrkucatcopë 0.90€

Neni 5

Neni 24 i rregullores baze , pika 3 taksa prej 4 euro duhet te behet 5 euro, pika 18 duhet te fshihet dhe në ne fund duhet te ceket pas pikës 19 ose 20 pra në fund të pikave duhet te theksohet se për Çertifikata shëndetësore të cilat lëshohen nga QKMF, AMF vlejn dispozitat e e Udhëzimit Administrativ 04/2013 sipas Shtojcës Nr.1 Çmimorja për çertifikata shëndetësore.

Neni 6

Te rregullorja baze neni 40.2, Me gjobë prej 4 € për m² deri me 6 € m² do të dënohen personat juridik dhe fizik qe veprojnë ne kundërshtim me nenin 12.1.3 dhe 12.1.4 te kësaj rregullore duhet tw permisohet **Me gjobe prej 10 € deri 50 € per personat fizik , për personat fizik që ushtron biznes individual 30 € deri 70 € ndersa personat juridik 30 Euro deri 150 € qe veprojne ne kundërshtim me nenin 12.1.3 dhe 12.1.4, dhe**

(Tek neni 6 shtohet sanksionet kundervajtëse me gjobë

4.3.për personi juridik nuk mund të jetë më pak se njëqindpesdhjet 150 euro dhe më shumë se dhjetëmijë 10.000 euro.

5.3.për personin juridik nuk mund të jetë më pak se njëqind 100 euro dhe më shumë se njëmijepesqind 15000 euro kur është fjala për kundervajtje të leta.

Sanksioni kundervajtës nuk mund të jetë më pak se 150 euro respektivisht 100 euro për kundervajtje të lehta.)

Neni 22

(Shtohet kopja e dokumentave të planifikimit hapsinor për secilin që i kërkon ato, Autoriteti komunal mund të ngarkoj një taksë të kostos reflektuese për qdo kopje.)

Neni 7

Pjesët tjera të rregullores baze mbasin të pa ndryshuara.

Neni 8

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave dhe pas publikimit në Web faqen



Viti, më 18.12.2020

Propozues, Kryetari i Komunës
z.Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Nga: Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë
Për: Kuvendin Komunal

Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën janar - dhjetor 2020

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunal të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Kuvendit Komunal të Vitisë dhe komiteteve funksionale që janë të themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, për periudhën janar- dhjetor 2020.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, ka të themeluar edhe komitete obligative dhe komitetet joobligative.

Kuvendi Komunal i Vitisë për periudhën janar-dhjetor 2020 ka mbajtur gjithsej IX mbledhje të rregullta, III të jashtëzakonshme, I urgjente. Kuvendi ka miratuar gjithsej 80 vendime, 3 rregullore dhe 2 ndryshim plotësime të rregulloreve, 1 deklaratë, ka shqyrtuar të gjitha kërkesat nga MAPL-ja.

Komiteti për Politik dhe Financa është komitet obligativ, i cili si çdo vit edhe në këtë vit është shumë aktiv, i cili deri me sot ka mbajtur IX mbledhje.

Komiteti për Komunitete gjithashtu është komitet obligativ, i cili këtë vit ka mbajtur VIII mbledhje.

Kuvendi Komunal i Vitisë ka të themeluar edhe komitetet konsultative funksionale si:

1. Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizuar, ka mbajtur V mbledhje të rregullta;
2. Komiteti për Pjesëmarrje të Qytetarëve në Vendimmarrje, ka mbajtur I mbledhje.

Përveç këtyre komiteteve, kemi të themeluar edhe komitete të tjera, si:

1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale;
2. Komiteti për Shërbime Publike;
3. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, ka mbajtur I mbledhje të rregullt;
4. Komiteti për Barazi Gjinore;
5. Komiteti për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mirëmbajtjen të Mjedisit.

Pothuajse të gjitha komitetet e cekura me lartë joobligative, nuk kanë qenë aktive.

Kryesuesi i Kuvendit
Naim Pira